

NrProt.

Tiranë, me _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi për ambjentet ku ushtron aktivitetin “OSHS” sha

KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Shërbime dezinfektimi nga parazitë-90922000-6; Shërbime dezinfektimi nga minjtë- 90923000-3; Shërbime dezinfektimi dhe asgjësimi- 90921000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,211,920 (një milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilat parashikohet se:

Neni 82, i LPP-së, pika 1: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP-së: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik, duhet të disponojë “Licencën profesionale Shërbime Ndërhjyresë Higjeno-Shëndetësore me Kod II.8.B (të vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, pika 4, shkronja “a”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 538, datë 26.05.2009, të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL)”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë që plotësojnë kriteret e duhura për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me ligjin.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve të bashkimit duhet të disponojë këtë certifikatë):

-ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent (e vlefshme), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent (e vlefshme), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent (e vlefshme), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Sqarim:* Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar, nga një përkthyes zyrtar i licencuar. Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Nëpërmjet kërkesave ndaj OE ofertues për të paraqitur certifikime ISO apo Certifikata/Deklarata Konformiteti CE etj, të cilat aplikohen edhe në Komunitetin European, bëhet e mundur që të sigurohet shërbim, që i përshtatet standarteve të kërkuara.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se e 40 % të vlerës së përlllogaritur të Marrëveshjes Kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” dhe pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”... “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të Marrëveshjes Kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave

të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 41, pika 3 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punësuar staf si më poshtë:

a) 1 (një) Drejtues Teknik. Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Diplomë me profesion Shëndet Publik /Biologji/Kimi/veterinari/mjedis oe fusha tw ngjashme që lidhen me objektin e kontratës.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Kontrate pune perkatese e vlefshme.
- Librezë pune.

b) Minimalisht 4 (kater) punonjes dezinfektimi, për të cilet duhet të paraqiten:

- Certifikata kualifikimi nga institucionet e licencuara për për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD, sipas legjislacionit në fuqi;
- Kontrata e punës e vlefshme.

Shënim: *Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DT, ndërsa përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari bën dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në*

rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të jenë origjinale ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës së shërbimeve, që kërkohen të prokurohen si dhe bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik dhe legjislacionit të posaçëm në përputhje me objektin e prokurimit, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Numri i punonjësve është kërkuar, në bazë të një përlllogaritjeje mesatare në raport me numrin dhe sipërfaqet e ambienteve, në administrim të AK, ku do të jetë e nevojshme kryerja e shërbimeve, si dhe në funksion të faktit që duhet të kryhen në momente specifike të ditës ose natës, dhe kjo garanton zhvillimin e shërbimit me disponibilitet të plotë në kohë, sasi dhe cilësi.

Në lidhje me funksionet dhe kualifikimet, theksojmë se kërkesa mbi stafin e sipërcituar, është e bazuar në dispozitat ligjore të Nenit 9, pika 2/a e Ligjit Nr. 95/2015, “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”: a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët Shëndet Publik /Biologji/Kimi/veterinary/mjedis ose fusha të ngjashme që lidhen me objektin e kontratës”. Duke u diktuar nga vetë specifika e objektit të prokurimit, që ka të bëjë me përdorimin e produkteve biocide, të cilat në momentin e mospërdorimit profesional të tyre përbëjnë rrezikshmëri të lartë në shëndet, sipas përcaktimeve në ligj është e domosdoshme të disponohen, përdoruesit profesionist, pra persona të trajnuar dhe të kualifikuar.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë sipas të cilës preparatet që do të përdorë për dezinfektim të jetë në përputhje me Specifikimet Teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar këtë kriter me qëllim garantimin e përdorimit të preparateve të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimeve të dezinfektimit, përdorimi i preparateve të përshtatshme, të sigurta dhe efektive përbën një element të rëndësishëm për realizimin me sukses të kontratës dhe për përmbushjen e standardeve të kërkuara të shërbimit.

Kërkesa për paraqitjen e deklaratës nga operatori ekonomik nuk synon kufizimin e pjesëmarrjes apo përcaktimin e një produkti/marke të veçantë, por vetëm garantimin që preparatet që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës do të jenë në përputhje me specififikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik me ane te një deklarate, duhet te marrin përsipër se per secilin produkt (objekt prokurimi) duhet te shoqërohet me etiketën dhe elementët përkatëse në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të deklaruar se produktet që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimit do të shoqërohen me etiketën dhe elementët përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bëhet e mundur garantimi i përdorimit të produkteve të identifikueshme, të sigurta dhe në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ky kriter është vendosur me qëllim sigurimin e një shërbimi cilësor, duke garantuar gjurmueshmërinë dhe përdorimin korrekt të preparateve të dezinfektimit gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik me ane te nje deklarate, duhet te marrin persiper, se me nenshkrimin e kontrates, duhet te paraqes per cdo produkt, raport-testimet si dhe certifikimet perkatese, te cilat duhet te jene sipas percaktimeve te specifikimeve teknike te AK, te leshuara nga organet kompetente te akredituara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të paraqitur raport-testime dhe certifikime përkatëse për produktet që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimit, të lëshuara nga organe kompetente dhe të akredituara, bëhet e mundur garantimi i cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë së produkteve me kërkesat e përcaktuara në Specifikimet Teknike të Autoritetit Kontraktor.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me shërbime dezinfektimi dhe përdorimin e preparateve përkatëse, dokumentacioni teknik provues është i nevojshëm për të siguruar që produktet që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës përmbushin standardet dhe kërkesat teknike të kërkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklaroj se disponon, pajisjet dhe mjetet, si më poshtë:

Nr.	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Pompë me presion	copë	3	Në pronësi ose me qera
2	Spërkatës shpine me presion	copë	3	Në pronësi ose me qera

- Në rastin e pronësisë, OE duhet të paraqesë faturën e blerjes së pajisjes ose dokumentacionin e zhdoganimit për pajisjet.

- Në rastin kur pajisjet janë në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë të shoqëruar me faturën e blerjes së pajisjeve;
- Skedën teknike/katalogun e pajisjes.
- Foto të pajisjeve

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DT. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, shkronja "ç", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë të dhëna dhe dokumente që lidhen me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik ka në dispozicion ose mund t'i vihen në dispozicion për realizimin e kontratës.

Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të deklaruar disponueshmërinë e pajisjeve dhe mjeteve teknike të nevojshme, si pompa me presion dhe sperkates shpine me presion, bëhet e mundur garantimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të shërbimit objekt prokurimi.

Pajisjet e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit të dezinfektimit dhe janë të domosdoshme për kryerjen e proceseve të punës sipas kërkesave të përcaktuara në Specifikimet Teknike.

Kërkesa që pajisjet të jenë në pronësi ose me qira është përcaktuar me qëllim që operatorët ekonomikë të kenë mundësi të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre pa kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni i kërkuar për verifikimin e pajisjeve synon vetëm të provojë ekzistencën, përshtatshmërinë teknike dhe mundësinë reale të përdorimit të tyre gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të deklaruar se shërbimi do të kryhet nga punonjës të pajisur me uniformën e punës dhe me materiale/pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë, bëhet e mundur garantimi i realizimit të shërbimit në kushte të sigurt dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë në punë.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me shërbime dezinfektimi, ku gjatë procesit të punës përdoren preparate dhe mjete që kërkojnë masa mbrojtëse, pajisja e personelit me uniforma

pune dhe mjete mbrojtëse personale është e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe realizimin korrekt të shërbimit.

Kërkesa për paraqitjen e deklaratës nga operatori ekonomik synon të garantojë angazhimin e tij për përmbushjen e kërkesave të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të elementeve të shërbimit objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT